



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 63 dt.30.04.1996

PER
PROPOZIM KESHILLIT TE MINISTRAVE PER DHENIE PENSION TE
POSACEM SHTETRORE PJESTAREVE TE FAMILJES TE POLICIT TE
VDEKUR NE DETYRE, REXHEP SKENDERI GJATA

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e dt.30.04.1996, pasi mori në shqyrtim relacionin nga Seksioni i Organizimit dhe Personelit të Aparatit të Bashkisë “Për dhënie pension të posaçëm shtetëror të pjestarëve të familjes së policit të vdekur(të vrarë) në detyrë, të kërkuar nga prindërit e tij dhe nga Ministria e Brendëshme.

Vëren se :

I ndjeri Rexhep Skënderi Gjata banor i fshatit Mullet të rrethit Tiranës kur po shkonte udhën Petrelë – Tiranë për në detyrën e tij si polic në ish Drejtorinë e Tiranës, është aksidentuar nga një automjet dhe ka gjetur vdekjen. Autori i krimit e ka lënë në atë gjendje dhe ende nuk është identifikuar.

Meqënëse çështja penale është pezulluar për mos zbulim të autorit, gjë që ka sjellë mos përcaktimin e motivit të krimit, i cili nëse do të ishte krim i kryer për shkak të detyrës si ushtarak pjesëtarët e familjes do të përfitonin pensionin përkatës, të bazuar edhe në faktet se ushtarakët sipas ligjeve tona gëzojnë mbrojtje të veçantë dhe se vdekja e tij e ka ndodhur në detyrë për të cilën Presidenti i Republikës e ka dekoruar me medaljen “Për ruajtjen e rendit shoqërorë”, mbështetur në nenin.5, të ligjit Nr.770, dt.11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore” dhe me VKM Nr.152, dt.05.04.1994 “Për kushtet e përfitimit dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçëm” dhe në bazë të nenit.21 të ligjit

Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”,

VENDOSI

1. Ti propozojë Këshillit të Ministrave që prindërit e të ndjerit Rexhep Skënder Gjata ish polic, Drejtorisë së Policisë të Tiranës ti akordohet një pension i posaçëm shtetëror në masën që përcakton vendimin përkatës i Këshillit Ministrave prej 880 lekë.
2. Ngarkohet Sektori Organizimit të ndjekë përfundimin e këtij propozimi.

KRYETARI

BESNIK PETRELA